

URDHËR

Nr. 874 / Datë 24/11/2015

PËR

PRISHJEN E SHOQËRISË "BERATEKS" SH.A, BERAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit I të Ligjit Nr. 8885, datë 22.4.2002, për disa ndryshime në Ligjin Nr. 7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", ndryshuar me akte të tjera ligjore, dhe Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", për shkak të situatës së vështirë ekonomiko-financiare dhe humbjes së objektit kryesor të aktivitetit, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë "Berateks" sha Berat,

URDHËROJ:

1. Prishjen e shoqërisë "Berateks" Berat dhe shpalljen e saj në likuidim.
2. Likuidator i shoqërisë emërohet Z. Gramoz Hazizolli, aktualisht Administrator i kësaj shoqërie.
3. Të hartohet bilanci i likuidimit në përputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
4. Z. Qani Kaja, Ekspert Kontabël i Autorizuar, të kryejë certifikimin e Bilancit të likuidimit.
5. Ngarkohet likuidatori i shoqërisë për kryerjen e veprimeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ARBEN AHMETAJ
MINISTËR